

## MARRËVESHJE SUPLEMENTARE NR. 2

1. Kjo Marrëveshje Suplementare nr. 2 do të konsiderohet si pjesë integrale e Marrëveshjes së Shitjes të lidhur me datë 27 prill 2004 nga dhe midis Calik Seker Konsorsiyum Yatirim dhe Bayindirbank A.S (Marrëveshja) dhe Marrëveshjes Suplementare të datës 24 mars 2005 (Marrëveshja suplementare).
2. ndërsa periudha e Marrëveshjes u shty deri me datë 30 qershor 2005 me anë të Marrëveshjes Suplementare, kësaj here, duke qenë se kësaj periudhe i ka kaluar afati, Marrëveshja dhe Marrëveshja e parë Suplementare janë shtyrë me anë të kësaj marrëveshjeje të dytë suplementare deri me datë 31 dhjetor 2005, së bashku me të gjitha dispozitat përkatëse.
3. letra e garancisë që i është dhënë Shitësit sipas Nenit 5.3, që i mbaron afati me datë 30 qershor 2005, do të rishikohet dhe do të paraqitet nga Blerësi (duke marrë në konsideratë rritjen e ekuiteteve të përmendura në bilancin e BKT-së) tek Shitësi.
4. kjo Marrëveshje Suplementare (Marrëveshja Suplementare nr.2) është firmosur me datë 8 nëntor 2005 dhe hyn në fuqi me datë 30 qershor 2005.

**BAYINDIRBANK A.S.**

Celik Goz  
(firma)

Omer Kalav  
(firma)

**Calik Seker Konsorsiyum Yatirim**  
Haluk Ulusoy  
(firma)

Hasan Basri Goktan  
(firma)

## MARRËVESHJE SUPLEMENTARE

Kjo Marrëveshje Suplementare do të konsiderohet si pjesë integrale e Marrëveshjes së Shitjes të lidhur me datë 27 prill 2004 nga dhe midis Calik Seker Konsorsiyum Yatirim dhe Bayindirbank A.S (Marrëveshja) dhe Marrëveshjes Suplementare të datës 24 mars 2005, me 12 nene (marrëveshja).

Termat e përcaktuara në Marrëveshje do të kenë të njejta kuptime kur përdoren në këtë Marrëveshje Suplementare, me përjashtim të rasteve të përcaktuara si më poshtë vijon.

1. Shitësi bie dakord të paguajë shumën e caktuar, me kusht që të provohet në dokumentet përkatëse (duke përfshirë dëmtimet, shpenzimet dhe të gjitha kostot e arsyeshme të avokatëve) për Blerësin, të cilën Blerësi pranon tua paguajë aksionerëve të tjerë për zhdëmtimin e dy aksionerëve të tjerë të BKT-së, që janë IFC-ja dhe EBRD-ja, të cilët, IFC dhe EBRD do të paguajnë personat juridikë të Grupit Suzer, i cili ka qenë aksioneri i mëparshëm, si rezultat i vendimeve të ekzekuteshme të gjykatës që lindin nga kushtet e Marrëveshjes.

Shuma totale e zhdëmtimit të lart përmendur do të jetë e kufizuar në vlerëm e shitjes së Aksioneve që i është paguar Bayindirbank-ës sipas neneve 5.1 dhe 5.2.

2. Letra e garancisë që i jepet Shitësit sipas nenit 5.3, afati i së cilës mbaron me datë 31 dhjetor 2004 do të rishikohet dhe paraqitet nga Blerësi (duke marrë në konsideratë rritjen e ekuitetit në bilancin e BKT-së) tek Shitësi.
3. Marrëveshja është shtyrë deri me datë 30 qershor 2005.
4. Kjo Marrëveshje Suplementare është firmosur me datë 24 mars 2005.


**BAYINDIRBANK A.S.**

Celik Goz

(firma)

Konsulent ligjor

Haluk Ersoy  
(firma)  
Anëtar i bordit  
Zëvendës Manaxher



**Calik Seker Konsorsiyum Yatirim**

Ahmet Calik  
(firma)  
Kryetar

Naci Ayhan  
Anëtar i Bordit

*Kjo Marrëveshje është e përjashtuar nga taksat, tatimet apo çdo tarifë sipas Nenit 14.5 (c) të Ligjit për Bankat nr. 4389.*